



Pranuar / Dorezuar Prenheno/Prilato Received/Delivruy	15.03.2022	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojçe Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUK	1385/2022		1/6

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.137/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.137/2022 të datës 16.02.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike „kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 15.03.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.137/2022 e datës 16.02.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi vendimi i Departamenti të Burimeve Njerëzore Nr.DM 257/2022 i datës 07.02.2022.

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në pozitën Kryesues i Njesisë për Përgatitjen e Shitjes, Shqyrtimit Ligjor dhe Tenderimit në Departamentin e Shitjes në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas Akt emërimit të datës 07.07.2017, ka aplikuar në konkursin sipas njoftimit të datës 15/12/2021 me afatin për aplikim nga data 14.01.2022 deri më 28.01.2022 me numër reference.RN00007978 për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Me datë 02.02.2022 Departamenti i Burimeve Njerëzore me vendimin Nr.DM 253/2022 refuzon aplikacionin e z. me arsyetimin se i njëjti nuk i plotëson kriteret e përcaktuara të konkursit.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e datës 02.02.2022 me nr.DM 253/2022 të Departamentit të Burimeve Njerëzore me datën 04.02.2022 ka parashtruar ankesë me Nr.419 në Departamentin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Departamenti i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit pas shqyrtimit të ankesës së ankuesit me datë 07.02.2022 ka nxjerrë vendimin me Nr.DM 257/2022 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me vendimet e Departamentit të Burimeve Njerëzore me datë 16.02.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 807/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 18.02.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ndërsa me datë 28.02.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e nxjerrjes së vendimit meritor në lidhje me këtë ankesë ka administruar këto prova:** Ankesa e ankuesit e datës 16.02.2022 me numër protokollit 807/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e konkursit i datës 14.01.2022-28.01.2022 për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në AKP; Përshkrimi i përgjithshëm ; Ankesa e datës 04.02.2022 me numër 419 e parashtruar nga ankuesi në Departamentin e Burimeve Njerëzore; Vendimi i datës 02.02.2022 me nr.233/2022; Vendimi i datës 07.02.2022 DM 257/2022 i Departamentit të Burimeve Njerëzore; Rregullorja Nr.2/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores së Pagave të Nëpunësve të Agjencisë; Formulari për Vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 20.12.2021; Përshkrimi i Punës për Kryesues të Njësisë për përgatitjen e Shitjes, Shqyrtimit Ligjor dhe Tenderimit i datës 19.07.2018; Formulari për caktimin e objektivave të Punës për periudhën janar-dhjetor 2021 i datës 26.01.2021; Plani individual i trajnimit i datës 26.01.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020; Plani individual i trajnimit i datës 22.01.2021; Formulari për përcaktimin e objektivave të punës për periudhën janar-dhjetor 2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i ulët dhe Profesionale për vitin 2020; Plani individual i trajnimit i datës 18.01.2021 për Formulari për përcaktimin e objektivave të punës për vitin 2021 i nënshkruar me datën 26.01.2021; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i ulët dhe Profesionale për vitin 2021 për Plani individual i Trajnimit i datës 26.01.2021 për Nehat Islami; Formulari për përcaktimin e objektivave të punës për vitin 2021 i nënshkruar me datën 18.01.2021 për Nermin Misini; ; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i ulët dhe Profesionale për vitin 2020 për Plani individual i trajnimit i datës 18.01.2021 për Formulari për përcaktimin e objektivave të punës për vitin 2020 i datës 25.01.2021 për Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i ulët dhe Profesionale për vitin 2020 i

datës 25.01.2021 për Plani individual i trajnimit për vitin 2021 i datës 25.01.2021  
 për Formulari për përcaktimin e objektivave të punës për vitin 2021 i datës  
 20.01.2021 për Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve  
 Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i ulët dhe  
 Profesionale për vitin 2020 i datës 20.01.2020 për Plani individual i trajnimit i  
 datës 20.01.2021 për Formulari për përcaktimin e objektivave për vitin 2021 i  
 datës 22.01.2021 për Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të  
 Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i  
 ulët dhe Profesionale për vitin 2020 i datës 22.01.2021 për Plani Individual i  
 trajnimit i datës 22.01.2021 për Formulari për Përcaktimin e objektivave të punës  
 për vitin 2021 i datës 25.01.2021 për Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në  
 Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i  
 Mesëm, i ulët dhe Profesionale për vitin 2020 i datës 25.01.2021 për Plani  
 individual i trajnimit i datës 25.01.2021 për Rregullore për Organizimin e  
 Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit e  
 datës 01.06.2017; Plotësim ndryshimi i Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe  
 Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit e datës 25.07.2018;  
 Përshkrimi i punës për pozitën Kryesues i Njësisë për Përgatitjen e Shitjes, Shqyrtimit Ligjor  
 dhe Tenderimit i datës 19.07.2018; Rregullore (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të  
 Punës në Shërbimin Civil; Rregullorja Nr.2 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores së  
 Pagave të Nëpunësve të Agjencisë; Përgjigje në ankesë e datës 28.02.2022 nga organi i  
 punësimit me numër protokolli 1042/2022 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/77; Vendimi i  
 datës 06.12.2021 me nr.ref.155/3 i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për  
 iniciimin e procedurës së rekrutimit për pozitën Drejtor Menaxhues të AKP-së; Kopja e  
 Konkursit për pozitën e Drejtor i Përgjithshëm i datës 14.01.2022 deri më datën 28.01.2022; Lista  
 e aplikantëve; Aplikacioni për i datës 26/01/2022; Çertifikatë e datës 16.12.2021  
 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë : Diplomë e datës 06.06.1995; Diplomë e datës  
 20.08.2018 Maxhister i Ekonomisë e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik i Universiteti i Tetovës;  
 Letër motivimi; Letër rekomandim; Letër rekomandim; Kopja e letërnjoftimit; Letër  
 rekomandimi i datës 12.02.2019; Vërtetim mbi punësim i datës 25.01.2022 me nr.280; shkresë e  
 datës 22.01.2008; Çertifikatë e datës 18.12.2018; Çertifikatë e datës 13.06.2014 e lëshuar nga  
 AUK; Çertifikatë e datës 23-24 tetor 2017; Vërtetim mbi punësim me datën 25.01.2022 me  
 nr.280; Vendim i datës 30.07.2012 e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;  
 Vendim i datës 16.12.2020 me nr.01/2591 e lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe  
 Teknologjisë; Formulari për përcaktimin e objektivave të punës për vitin 2021 i datës 11.01.2021;  
 Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të  
 Shërbimeve Publike për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i ulët dhe Profesionale për vitin 2020 i  
 datës 12.01.2021 për Plani individual i trajnimit për Formulari  
 për përcaktimin e objektivave të punës për vitin 2021 i datës 20.12.2021; Formulari për  
 Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike  
 për Kategorinë Drejtues i Mesëm, i ulët dhe Profesionale për vitin 2021 i datës 20.12.2021; Plani  
 individual i trajnimit i datës 20.12.2021; Vendimi i datës 02.02.2022 me nr.DM 253/2022; Lista e  
 aplikantëve të aprovuar dhe aplikantëve të refuzuar; Njoftim i datës 03.02.2022 i Departamentit  
 të Burimeve Njerëzore për listën e ngushtë; Ankesë e datës 04.02.2022 me nr.419 e parashtruar  
 në Departamentin e Burimeve Njerëzore; Vendim i datës 07.02.2022 me nr.DM 257/2022;  
 Njoftimi i datës 09.02.2022 për listën e ngushtë; Akt emërimi i datës 07.07.2017 me nr.ref



04/DSH 2 për Parashtrësë për plotësimin e ankesës të datës 04/03/2022 dhe Vendimi i datës 14.02.2022 i nxjerrë nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve për Formimin e Komisionit ad hoc i Pranimit për pozitën e lartë drejtuese, aplikacionet e punësimit për kandidatët që janë pjesë e listës së ngushtë, njoftimi për pezullim të procedurës së rekrutimit i datës 23/02/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa bazuar *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, sipas shkresave të lëndës ka konstatuar se Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datë 06.12.2021 ka nxjerrë vendimin me Nr.ref BD-155/3 për inicimin e procedurës së rekrutimit për pozitën Drejtor të Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit përmes konkursit publik, vendim i nënshkruar më datë 06/12/2021 ndërsa Departamenti i Burimeve Njerëzore sipas njoftimit të datës 15/12/2021 ka shpallur konkursin publik me afatin për aplikim nga data 14.01.2022 deri më 28.01.2022 me numër reference RN00007978 për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, bazuar në dispozitat e nenit 40, paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.15/2020 për Pranim, Vlerësim dhe Disiplinë të Nivelit të Lartë Drejtues.

Konkursi sipas njoftimit të datës 15/12/2021 me afatin për aplikim nga data 14/01/2022 deri më 28.01.2022 me numër reference RN00007978 për pozitën Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar si vijon:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to,*
- *Kualifikime të posaçme formale,*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tetë(8) vite përvojë pune profesionale duke përfshirë së paku pesë(5) vite përvojë pune në pozita drejtuese.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave ka konstatuar se për këtë pozitë kanë aplikuar gjashtë (6) kandidatë, ankuesi për këtë pozitë të punës, ka aplikuar me datë 26.01.2022 me numër reference RAN0002340, ndërsa me datë 02.02.2022 Departamenti i Burimeve Njerëzore ka nxjerrë vendimin me Nr.DM 253 /2022 me të cilin ka refuzuar aplikacionin e z. Limani i cili nuk kualifikohet për procedurat e mëtejme të rekrutimit sepse nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me nenin 40 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se "1. Pranimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese bëhet me konkurrim të organizuar për çdo pozitë të lirë. Fillimisht, kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurrim vetëm nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili konteston vendimin e Departamentit të Burimeve Njerëzore me arsyetimin se në vendimin për refuzim thirren vetëm në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në Ligjin Nr.06/113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura dhe Rregulloren Nr.26/2020 për planifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ky pretendim është i



paqëndrueshëm sepse Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në vendimin e datës 06/12/2021 ka inicuar procedurën e rekrutimit për pozitën Drejtor Menaxhues në AKP përmes konkursit publik, bazuar në Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr.04/L-034(të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.06/L-023,Ligjin nr.05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115),nenit 9.5 të Statutit të bordit të AKP-së, si dhe neneve 6,8,1,40 dhe 42 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 6.2 të rregullores Nr.15/2020 për pranimin, vlerësimin dhe disiplinën e nëpunësve të lartë drejtues, mbi bazë të këtyre dispozitave ligjore janë paraparë edhe kërkesat e përgjithshme formale të konkursit të publikuar dhe mbi bazë të provave që kemi administruar me rastin e kësaj ankese të dorëzuar nga palët konstatohet se i njëjti përkundër që aludon në shkelle të dispozitave ligjore të shërbimit civil konteston edhe aplikimin e dispozitave materiale që janë aplikuar me rastin e përjashtimit nga procesi i mëtutjeshëm konkurrues sipas këtij konkursi me faktin që nuk ka hyrë në listë të ngushtë dhe se i është refuzuar ankesa për vazhdim të procedurës së rekrutimit për pozitën Drejtor Menaxhues në AKP, ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet formalo-juridike të konkursit nga se i njëjti është i punësuar në AKP si Kryesues i Njesisë për Përgatitjen e Shitjes, Shqyrtimit Ligjor dhe Tenderimit në këtë institucion sipas Akt emërimit aktual të datës 17/07/2017 dhe bazuar në rregulloren Nr.26/2020 për klasifikim të vendeve të punës në shërbimin civil nuk klasifikohet në kategorinë e nëpunësve civil të nivelit të mesëm ose të lartë drejtues, por pozitë e nivelit të ulët drejtues, poashtu edhe sipas strukturës organizative të AKP-së, kjo pozitë është e nivelit të ulët drejtues, e që është pengesë ligjore për aplikim në pozitë të nivelit të lartë drejtues. Në bazë të shkresave të lëndës vërtetohet fakti se i njëjti nuk ka qenë aktualisht në pozitë të nivelit të mesëm apo të lartë drejtues, poashtu nga shkresat e lëndës konfirmohet fakti se kandidatët që janë pjesë e listës së ngushtë kanë përvojë të mjaftueshme menaxheriale dhe janë aktualisht në pozitë të nivelit të mesëm drejtues dhe i plotësojnë kriteret sipas këtij konkursi për pozitë të Drejtorit Menaxhues në AKP.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit i cili thekson se Departamenti i Burimeve Njerëzore nuk është në dijeni me përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Kryesues i Njesisë për Përgatitjen e Shitjes, Shqyrtimit Ligjor dhe Tenderimit në Departamentin e Shitjes në Agjencinë Kosovare të Privatizimit i cili udhëheq dhe menaxhon me staf dhe njëkohësisht bënë vlerësimin e stafit si mbikëqyrës i drejtpërdrejt, edhe ky pretendim i ankuesit është i paqëndrueshëm sepse pozita Kryesues i Njesisë për Përgatitjen e Shitjes, Shqyrtimit Ligjor dhe Tenderimit në Departamentin e Shitjes në Agjencinë Kosovare është pozitë e nivelit të ulët drejtues sepse z.Arlind Limani mbikëqyrës të drejtpërdrejt e ka Drejtorin e Departamentit të Shitjes i cili është kategori e nivelit të mesëm drejtues i cili e vlerëson për rezultatet në punë e jo Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, dhe ky fakt është konfirmuar edhe nga formularët e vlerësimit që gjenden në shkresat e lëndës.

Po ashtu Departamenti i Burimeve Njerëzore ka shpjeguar pozitën e Kryesuesit të Njesisë për Përgatitjen e Shitjes, Shqyrtimit Ligjor dhe Tenderimit në Departamentin e Shitjes në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, bazuar në strukturën organizative të Agjencisë dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit , Departamenti i Shitjes në AKP udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit i cili i raporton Zëvendës Drejtorit Menaxhues -shitje dhe përbëhet nga këto njësi : njësia e përgatitjes së shitjes, shqyrtimit ligjor dhe tenderimit ,njësia e kadastrit dhe njësia për përgatitjen e kontratave të shitjes.

Ankuesi me datë 04/03/2022 ka parashtruar prova shtesë në Këshill i cili pretendon se Formimi i Komisionit të Pranimit është i kundërligjshëm sepse është në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit Nr.06/L-023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-115, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se edhe ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse Vendimi i datës 14.02.2022 i nxjerrë nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve për Formimin e Komisionit ad hoc i Pranimit për pozitën e lartë drejtuese është nxjerrë në pajtim me nenin 41 paragrafi 5 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se “. 5. “Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese, që themelohet në çdo institucion tjetër shtetëror, është ad hoc. Ai themelohet nga titullari i institucionit dhe përbëhet nga: 5.1. një përfaqësues i Njësisë përgjegjëse të institucionit; 5.2. dy nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese nga institucioni apo nga një institucion tjetër i Shërbimit Civil me përgatitje të veçantë në procesin e përzgjedhjes; 5.3. dy ekspert të jashtëm në procesin e përzgjedhjes nga organizata të specializuara.” dhe nenin 10 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin ,Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues .

Bazuar në Legjislacionin në fuqi të Shërbimit Civil dhe mbi këtë bazë ligjore të specifikuar më lartë vendimi i Departamentit të Burimeve Njerëzore Nr.DM 257/2022 i datës 07/02/2022 është nxjerrë në harmoni me legjislacionin në fuqi të shërbimit civil, andaj pretendimet e ankuesit janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda,A.nr.137/2022, datë 15.03.2022

Sabile AVDYLI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- ❖ Ankuesit
- ❖ Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

